

INTERVISTË E KRYETARIT TË PREZENCËS ME “ORA NEWS” PAS RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË OSBE/ODIHR-IT PËR ZGJEDHJET VENDORE 2011

15 gusht 2011

Z. Ambasador, OSBE/ODIHR-i bëri publik sot raportin përfundimtar për zgjedhjet vendore 2011. Cili është mesazhi juaj për krerët e politikës në Shqipëri?

Ambasadori Wollfarth: Gjëja më e rëndësishme është që raporti i zgjedhjeve vendore 2011 të lexohet tërësisht, nga fjala e parë në të fundit. Ai përmban, gjithashtu, edhe rekomandime të qarta dhe të renditura sipas përparësisë. Po përmend vetëm dy prej tyre. Njëri ka të bëjë me vullnetin politik. Është e qartë nevoja për vullnet politik dhe ky vullnet është kyçi për hapat e mëtejshëm, të cilët duhet të ndërmerren me shpejtësi. Koha për zgjedhjet e ardhshme parlamentare të vitit 2013 po ecën. Kjo kohë duhet përdorur sa më shpejt, menjëherë me fillimin e sesionit të ri parlamentar në shtator. Pra, partitë duhet ta përdorin këtë kohë dhe të tregojnë vullnet të qartë politik.

Rekomandimet më të rëndësishme lidhen me reformën zgjedhore. A mendoni se reformimi i Kodit Zgjedhor është shumë i rëndësishëm?

Ambasadori Wollfarth: Ai do të ndihmonte në rritjen e besimit të zgjedhësve të sistemi. Pamë një Ditë Zgjedhjesh të mirë dhe një proces numërimi të koklavitur. ODIHR-i ka raportuar lidhur me këtë dhe ka dalë me 27 rekomandime. Sigurisht, tani është shumë e rëndësishme të punohet mbi 31 rekomandimet e vitit 2009, 27 rekomandimet e këtij viti dhe, gjithashtu, të dëgjohen me vëmendje vëzhguesit kombëtarë. Dua ta theksoj këtë fakt. Zgjedhjet e fundit u vëzhguan në masë edhe nga shqiptarët që i shërbyen vendit të tyre dhe ata mund të jenë pjesë e bisedimeve lidhur me reformën, në mënyrë që procesi të përfundojë me një zgjidhje vërtet të mirë.

A mendoni se z. Berisha, z. Rama dhe politikanët e tjerë janë të gatshëm të nisin bashkëpunimin?

Ambasadori Wollfarth: Duhet të jenë të gatshëm. Duhet të jenë të gatshëm t'i shërbejnë vendit të tyre.

Fund